



Thjesht Linda

Nga Iva Tiço

Një veshje e thjeshtë bardh e zi, këmishë e pantallona, syzet e zeza mbi flokë dhe ecja vajzërore në majë të gishtave nuk tërheqin vëmendjen e askujt nga ato pak tavolina të mbushura në pjesën e kafenesë së “bukëve dhe ëmbëlsirave franceze” në orar dreke. “Diskrete” – kështu e kanë përcaktuar të gjithë ata që e njohin, pak apo shumë, gjatë asaj jave të vetme të dhjetorit, kur, brenda tri ditëve, nga një personazh i panjohur, Linda Rama u gjend në të gjitha faqet e para të gazetave e revistave, në emisione lajmesh apo biseda studiosh televizive. Për një javë të tërë, ajo dhe historia e saj me Kryetarin e Bashkisë së Tiranës, njëkohësisht kreun e opozitës, qe në gojën e të gjithëve, ndonëse ajo pranoi të shfaqej në një intervistë të vetme, në studion e “Top Story”-t. Sigurisht që ato ditë kërkesat ishin të panumërta. Përderisa gazetarët intervistonin që nga organizatorët e dasmës e deri tek analistët, nuk kishte si të mungonin përpjekjet për të intervistuar protagonistët... Kështu, pas disa rekomandimeve të njohurish të përbashkët, lidhem në telefon me Linda Ramën, vetëm një ditë përpara dasmës. Duket mjaft e dashur dhe miqësore, është dakord të dalë në kopertinën e revistës “JETA”, por e lëmë të flasim pas dasmës për detajet, për intervistën dhe fotot. Pas konsumit mediatik të fotove të dasmës, nuk ia vlen më të merremi me histori me nuse e dhëndër, ia vlen që të kalojë edhe ca kohë përpara se Linda të dalë në një kopertinë reviste... Në sms të shkëmbyera për urimet e vitit të ri, vijojmë të kujtojmë premtimin e një kopertine që do të bëjmë...

Deri në fund të shkurtit, kur duket se është çasti i duhur. Tre muaj larg asaj bujës së nëntorit dhe tre të tjera larg datës së zgjedhjeve.

“Nuk ka fare lidhje me zgjedhjet! .E pse duhet të jem unë në kopertinë gjatë fushatës?!” – pyet Linda, ndërsa unë i shpjegoj që, në atë periudhë, kërkesat e gazetarëve pritet të jetë po aq këmbëngulëse, sa gjatë javës së dasmës. “Prandaj është më mirë tani”, thotë ajo, duke zgjedhur të shfaqet pikërisht në këtë kohë, kur jo vetëm fushata zyrtare nuk ka nisur, por edhe kur bashkëshorti i saj nuk është shprehur publikisht nëse do jetë ai apo jo kandidati për Bashkinë e Tiranës. Zgjedh, pra, të shfaqet, por pa u lidhur domosdoshmërisht me datën e zgjedhjeve. Në të njëjtën mënyrë siç e kishte paralajmëruar në të vetmen intervistë televizive, që do qëndronte në krah të të shoqit, por pa u marrë mirëfilli me politikë, duke ruajtur atë tipar me të cilin e kanë përcaktuar të gjithë ata që e njohin, “diskrete”

Për vite me radhë keni ruajtur një profil të ulët publik, duke mos u shfaqur në media, ndonëse shumë pedagogë apo aktorë të shoqërisë civile si ju janë shndërruar në protagonistë (shumë kolegë të mi e patën të vështirë të gjenin foto apo filmime tuajat). Pse kjo zgjedhje?

Pikërisht për një dëshirë, një zgjedhje të bërë herët, edhe me vetëdijen se të qenit protagonist në jetën që na u dha mundësia e mrekullueshme të jetojmë, nuk lidhet kurrësi domosdoshmërisht me shfaqjen në media. Kam respekt për protagonistët që njohim përmes medias, por kam njohur në vetë të parë apo përmes librave plot protagonistë që nuk i ka kapur syri i medias. Protagonistë të jetës, si një mundësi për të qenë të dobishëm për të tjerët, jashtë kamerave, larg lajmit të ditës, matanë horizontit të vëmendjes mediatike.

Si bëhet kjo?

S’ka as receta e as hierarki të vendosshme në këtë aspekt. Secili bën zgjedhjen e vet të respektueshme. Fjala vjen, duke drejtuar matanë periferisë së vëmendjes mediatike një projekt që lidhet me komunitetin rom, je vetiu një protagonist për ata që s’kanë zë dhe shpeshherë as figurë në perceptimin kolektiv, jo më në media. Po për një studiues të angazhuar, për dikë që, si unë, lexon e shkruan me dëshirën që të jetë i dobishëm për të tjerë, kjo është sfida e zgjedhur. Nuk jam e vetmja që kam bërë këtë zgjedhje, madje guxoj t’ju them se ndihem në distancë higjienike të sigurt nga mjedisi i rrëmujshtëm i protagonizmit të ditës, kur gjendem mes të ngjashmish, të cilët në “heshtjen” e tyre flasin me gjuhën e së dobishmes, që s’përbën lajm.

Ç’do të thotë për një njeri që ka ruajtur të tillë profil të gjendet befas në të gjitha edicionet e lajmeve dhe faqet e para të gazetave?

Kapërcimi për disa ditë nga zona e “heshtjes” në faqet e para të gazetave ishte diçka e pashmangshme, në kushtet kur zgjedha të lidh jetën time me një njeri që për shkak të angazhimit të tij politik me publikun gjendet në faqet e para. E drejtë e padiskutueshme e medias për të informuar publikun, duke qëmtuar nga afër zgjedhjen e tij, jo timen në fakt, si dhe e drejta e publikut për t’u informuar nga media mbi atë që u bë gruaja e Edi Ramës, por kaq. Pak ditë nën reflektorët e fortë, thuajse verbues, e pastaj gati bezdisës të skenës, pastaj një vijim i natyrshëm i jetës në distancë me atë skenë ku im shoq gjendet përditë, sepse ka zgjedhur të jetë protagonist në arenën politike. Ndërkohë, unë kam zgjedhur atë që Edi është përtej këtij protagonizmi, njeriun e panjohur për shumëkënd, po shumë të dashur për mua.



Por edhe pse pak ditë nën këta reflektorë të fortë, tashmë anonimati ka humbur njëherë e përgjithmonë. Si e përjetoni këtë ndryshim, të qenit nën vëzhgim?

Shpresoj të mos kem ndryshuar unë, pavarësisht ndryshimit të jetës sime nga një jetë si të gjitha jetët e pavëzhguara të qytetit tonë, në një jetë të vëzhguar nga i gjithë qyteti. Por s’do të isha plotësisht e hapur me ju nëse s’do t’ju thosha se, gjithsesi, edhe për mua diçka ka ndryshuar shumë.

Konkretisht, qoftë pse dashamirësit e Edit, jo të paktë në këtë qytet, hera-herës më ndalojnë duke më përcjellë ngrohtësi apo qoftë pse, megjithëse shumë më të pakta, nuk mungojnë rastet kur ndjem keq për rezonancën e fjalëve keqdashëse ndaj tij. Megjithatë s'mund ta fsheh se "humbja e anonimatit" ka shtuar energjinë pozitive që më rrethon në kontaktet me njerëzit.

A ndjeni mall për kohën kur ishit më e shkujdesur?

Jo, mbase sepse, me natyrën që kam, nuk kam qenë asnjëherë e pavëmendshme ndaj mjedisit ku jetoj dhe njerëzve të njohur apo të panjohur përreth.

Për sa u takon të njohurve, për shkak të karrierës suaj, si në administratën shtetërore, ashtu dhe në shoqërinë civile, duhet të keni miq si "kampin" e socialistëve, ashtu dhe të demokratëve. Si kanë ndryshuar këto raporte pasi lidhjes suaj me Edi Ramën?

Asnjë lloj ndryshimi, madje dua të theksoj që kjo nuk është vetëm për meritën time, por edhe për meritë të miqve e të të njohurve të mi. Në dasmën tonë na nderuan të gjithë me praninë e tyre dhe u ndjeva e ndihem mirë për faktin që njohja dhe miqësia e ndërtuar prej vitesh me demokratë të vërtetë të tillë nuk është cenuar aspak nga lidhja ime me Edi Ramën. Ashtu sikundër asgjë nuk ka ndryshuar në shoqërinë time me miq e të njohur socialistë për shkak të faktit se unë jam gruaja e Edi Ramës. Ata kanë qenë e do mbeten njësoj për mua dhe unë për ta kam qenë e do jem thjesht Linda.

Linda, por që, prej pak muajve, njihet me një tjetër mbiemër, Rama. Sa ua ka ndryshuar jetën ky mbiemër?

Unë nuk kam ndryshuar emrin, vetëm mbiemrin. Pra, jam po ajo Linda që kam qenë, që kujdeset për fëmijët, për prindërit, për motrën e vëllain. E njëjta Lindë që preokupohet për çdo gjë që nuk shkon mirë për një mik, shok a shoqe apo të njohur dhe i gëzohet çdo të mire që atyre u ndodh. Po ajo Linda, pjesë e shoqërisë civile dhe jetës universitare, ndjekëse e pasionuar e zhvillimeve ekonomike e sociale në Shqipëri e gjetkë për qëllime mirëfilli akademike. Brenda meje nuk ka ndryshuar asgjë në thelb. Është pasuruar, po, përmbajtja e jetës sime. Më janë shtuar detyrime e kënaqësi që lidhen me dashurinë, familjen, me miq e shqetësime të përbashkëta, por s'më ka ndryshuar dëshira për ta jetuar jetën brenda një rrethi njerëzish e gjërash, që mbeten thjesht të miat.

Në këto gjëra që janë shtuar bëjnë pjesë edhe vizitat e ndryshme, ku ju shoqëroni Edin, siç qenë, për shembull, edhe ngushëllimet e fundit... Në të tilla raste, jeni ju që kërkon ta shoqëroni apo është ai që kërkon praninë tuaj dhe të nënës së tij?

As njëra as tjetra! Thjesht, ne jemi bashkë, gëzimet e hidhërimet i ndajmë bashkë. Rasti tragjik që ju i referoheni ishte një rast, që do jepja çfarë të mundesha për të mos e jetuar. Ishte një rast që preku familjen tonë, besoj si çdo familje shqiptare, që jo vetëm pa vrasje njerëzish në mes të Tiranës, po edhe mësoi diçka më shumë për jetët, hallet, rrethanat familjare të këtyre njerëzve të varfër, të papunë dhe tërësisht të pafajshëm. Ngushëllimet në familjet e tyre s'ishin protokollare, po thjesht njerëzore, si te njerëz të afërm të pllakosur nga një fatkeqësi e pangushëllueshme.

Keni thënë ndërkohë që do vijoni të mbeteni një mbështetëse e karrierës politike të Edit, pa u bërë kurrë protagoniste në politikë. A keni ndonjë model të tillë “gruaje të parë”?

Po, unë do ta mbështes Edin, pa u kursyer, në angazhimin e tij politik me publikun, pasi ndjej pasionin, besimin e sinqeritetin e tij. Unë besoj në fuqinë që Edi ka për t'u përballur vendosmërisht me problemet, për t'i bërë gjërat mirë dhe, mbi të gjitha, për të mos lënë askënd në baltë. Edi është një njeri i vërtetë dhe po aq i vërtetë është edhe suksesi i tij. Se cili do të jetë modeli që unë do të ndjek përgjatë këtij rrugëtimi, nuk kam kërkuar asnjë model për të kopjuar, sepse besoj që më mjafton të jem thjesht ajo që jam, pavarësisht admirimit që kam për gra të njohura, të cilat kanë kaluar me dinjitet e rrezatim mbresëlënës përmes kësaj rruge, ashtu siç respektoj çdo grua që është sot pranë një burri në politikë në këtë vend ku politika mbetet burimi i një stresi të pashoq për ata që e bëjnë dhe ata që e ndjekin.

A lexoni ju çdo gazetë apo ndiqni lajmet ku flitet për Edi Ramën?

Çdo gazetë?! Jo jo...dhe jo vetëm sepse dita ime është shumë e zënë për shkak të mënyrës sesi organizoj kohën dhe natyrës së punës që kam zgjedhur, por edhe sepse kam gjetur, kohë më parë, një rrugë selektive të marrjes së lajmeve nga jeta e përditshme e vendit. Kjo s'do të thotë se nuk i ndjek vijimësisht zhvillimet e këtushme, edhe ato politike, përkundrazi. Kam qenë gjithnjë një qytetare e interesuar, përveçse një studiuese e detyruar të ndjekë ecurinë e punëve në këtë vend. Përfshirja në jetën e Edit s'ka asnjë dyshim se më ka rritur vëmendjen në drejtim të procesit politik, ku ai është me mish e me shpirt i përfshirë.



Si i përjetoni sulmet politike që i bëhen atij?

Varet shumë se nga goja apo pena e kujt dalin këto sulme dhe, në fund të fundit, le ta themi qartë, tjetër sulmet me baltë e tjetër sulmet sado të ashpra brenda etikës. Këto të dytat, jo rrallë me autorë njerëz që unë i respektoj e, në disa raste, edhe i numëroj ndër miqtë, janë tjetër, krejt tjetër kapitull. Ndërsa sulmet me baltë, ato që dalin nga gojë tellallësh të përçudnisë së komunikimit publik, i përjetoj në radhë të parë si një prapambetje të madhe për vendin ku jetojmë, me pasoja mbresuese për të gjithë ata që e jetojnë sot këtë vend. Jam e keqardhur për persekutimin psikologjik që shpifjet po i bëjnë shoqërisë sonë, duke i varfëruar njerëzit shpirtërisht dhe duke i përdorur ata për qëllime të mbrapshta. Mbase ky është një çmim që ende duhet t’ia paguajmë shtypjes psikologjike të ideologjisë së shkuar të urrejtjes për të ndryshmin. Sidoqoftë, duket se u bë një kohë më e gjatë sesa kufiri i durimit të njeriut normal ndaj kësaj gjuhe të pangjashme me asgjë, që mund të thuhet mes palësh apo njerëzish normalë në botën e sotme demokratike. Ndërsa ato që i bëhen specifikisht Edit nga baltëfolës apo baltëshkrues, thuajse përditë, i dëgjoj sigurisht si të pavërtetat e radhës, por ka raste që edhe mërzitem.

Në cilat raste mërziteni?

Në rastet kur preken të tjerë, padrejtësisht, përtej çdo caku të imagjinueshëm, edhe përtej cakut të logjikës së një përfitimi politik, që unë nuk besoj se i vjen ndokujt, në këmbim të një gjuhe vrazhdësisht të papranueshme për çdo mendje e vesh normal. Nëna e lënduar krejt padrejtësisht me të pavërteta skandaloze! Babai që nuk jeton më, pasi s’ka bërë tjetër veçse ka jetuar denjësisht jetën e tij, ndërkohë baltoset egërsisht! Gregu, djali që dëgjon monstruozytete të shpikura dikur nga ata që sot shpifjet e tyre i renditin si gjoja fakte, për të përçudnuar publikisht imazhin e kundërshtarit politik! Ç’t’ju them, i dini dhe dihen nga të gjithë mbase përmendësh sot gjithë shpifjet që përsëriten e përsëriten, si në një lojë me detyrim-

përcaktim për këtë shoqëri që i dëgjon përditë nga politika e helmimit të mendjeve, ndërkohë që pret politikën e melhemit të plagëve. Më e keqja është të mësuarit me këtë helm, të kthyerit e këtyre skandaleve etike e gjuhësore në rutinë, të bërit e baltës së shpifjeve mjet i zakonshëm ballafaqimi me tjetrin. Mbase, kështu mund të shpjegohet transformimi befasues në autorë skandalesh të tilla edhe i disave, burra ose gra, që dikur, jo vetëm kam patur rastin t’i njoh, në opozitë apo në shoqërinë civile, por edhe t’i inkurajoj për një rol aktiv në politikë, pa e menduar dot deformimin që do t’u bënte pushteti.

Në fakt, politika dhe pushteti e kanë shndërruar jo pak dhe Edi Ramën, njeriun me të cilin tashmë Linda ka vendosur të lidhë jetën. Në atë intervistë të parë në “Top Story”, Linda ka folur pak dhe për atë Edin e dikurshëm antikomformist, meveshjetallasojshe, të cilit ajo i dashuronte penën. Kalënë edhe të kuptojë që ajo do ta donte ashtu edhe në të ardhmen... Edhe gjatë bisedës sonë, nuk e fsheh bindjen se egjithakjo është një çështje kohe, se kur Edi Rama do ta ketë kryer gjithë ciklin e vet politik, do të rhiqet nga politika aktive e do u rikthehet pasioneve të dikurshme, kryesisht të shkruarit dhe pikturës.



Flisni për një kohë kur Edi Rama, pasi të ketë përmbushur atë që ju e quani misionin e tij politik, do të rhiqet...

Siç e thotë edhe vetë, por siç e shoh edhe unë, profesioni i Edit nuk është politika, paçka se sot është i angazhuar tërësisht në politikë. Vetëm ata që politikën e kanë profesion, ata që nuk dinë të bëjnë asgjë veç “politikës” ose ata që e bëjnë politikën vetëm sepse mund të nxjerrin përfitime të paligjshme, nuk e kanë të mundur të largohen prej saj. Edi nuk bën pjesë në asnjërën prej këtyre kategorive, që s’do të thotë aspak se unë mendoj që politika s’është një profesion i respektuar. Përkundrazi, pa politikanët s’do kishte progres shoqëror dhe politikanët profesionistë s’janë absolutisht të gjithë njësoj, mediokër apo sharlatanë.

Si e mendoni atë Edin mes pikturës dhe penës? Do i kthehet ai sërish edhe veshjes antikonformiste të dikurshme apo xhaketat dhe kravatat janë bërë dashuri e përhershme?

Pena dhe ngjyrat janë bashkudhëtare besnike të Edit edhe sot, në fjalët e tij të shkruara apo ngjyrat që le përditë mbi letrat e punës. Megjithatë, unë e pres me shumë dëshirë e kuriozitet ditën kur ai do të këtë më shumë kohë për to. Por nuk do guxoja të paracaktoja zgjedhjen e tij për të ardhmen thjesht si një kthim në studion e piktorit, ku i dihet çfarë mund të lindë në kokën e tij... E kam dëgjuar disa herë, fjala vjen, se do t'i pëlqente shumë një ditë të qepte rroba për miqtë e të njohurit! Për sa i takon veshjes, mendoj që dashuria e përhershme e Edit nuk është as veshja antikonformiste e dikurshme dhe as xhaketat dhe kravatat që kanë gjithashtu antikonformizmin e tyre. Është pasioni për të bukurën.

Kenithënëqëdikur,ajoqëjukapëlqyer më shumë nga Edi, është pena e tij. Tani keni privilegjin të lexoni e para atë që ai shkruan.

Edi është padyshim një ndër lëvruesit e shqipes që, pa e njohur, ka fituar admirimin tim, qysh shumë herët. Publicistika e tij në vitet '90 ishte si një eksplorim në thesarin gjuhësor të shqipes, përmes të cilit ndërtohej mendimi vizionar dhe fshikullues i një njeriu shumë të veçantë për kohën. Sot është po ai njeri, por, megjithëse roli që ka është tjetër dhe koha po ashtu tjetër, pena e Edit mbetet një arsye e fortë për t'u ndjerë thellësisht e privilegjuar si lexuesja e parë e atyre që ai shkruan.

Miratoni çdo gjë që ai shkruan apo thotë apo për çështje të caktuara ndani mendime të kundërta?

Ne jemi shumë komplementarë, sepse jemi të ndryshëm dhe, si të tillë, padyshim, kemi gjithnjë arsye e kënaqësi të debatojmë për qasjen ndaj çështjeve të caktuara, por s'kemi thujas asnjëherë dallim në parimet e vlerat që ndajmë bashkërisht.

A është Edi Rama natyrë që dëgjon këshillat?

Krejt ndryshe nga ai që thuhet apo edhe duket, Edi është një njeri me një interes shumë të veçantë, thujas obsesiv, për të kërkuar dhe dëgjuar sa më shumë pikëpamje lidhur me çdo çështje që i intereson. E di që e keni të vështirë të më besoni, me gjithë ato që janë shkruar e thënë për të si njeri që bën çdo gjë në kokën e vet. Mirëpo kjo s'më pengon t'ju them se ai i do këshillat, i kërkon nga gjithkush që mendon se mund ta ndihmojë me një këshillë lidhur me një problem për t'u zgjidhur. Edi nuk e ka aspak të vështirë të pranojë e të bëjë të veten çdo këshillë bindëse. Është diçka tjetër

pastaj vendosmëria e tij për të mbrojtur bindjet apo pozicionet e marra, pasi këshillohet. Në këtë pikë, s’kam parë njeri më të vendosur.

A është kjo e juaja një nga ato dashuritë që vijnë si pasojë e miqësisë dhe ndarjes së ideve të njëjta apo tërheqje e të kundërtave?

Më lejoni ta kaloj me një buzëqeshje shumë dashamirëse këtë pyetje tuajën. Po të shpjegohej dot kështu, s’do quhej dashuri.

Po mund të na tregoni së paku se cilat janë ato gjëra që të kanë pëlqyer më shumë tek Edi... Ç’ju ka bërë të bini në dashuri me të?

Edi ka cilësi që të bëjnë ta jetosh jetën cilësisht, jo vetëm për vete. Mbi të gjitha, është shumë i hapur, i afërt e i drejtpërdrejtë. Ka një kreativitet jashtëzakonisht tërheqës në komunikim dhe bën çdo përpjekje që t’i bëjë të ndjehen mirë njerëzit, kur janë me të. E kënaq çdo punë e mirë e të tjerëve. Nuk është asnjëherë xheloz për suksesin e dikujt tjetër dhe ka një nxitje të brendshme për të inkurajuar çdo mundësi për sukses të të tjerëve. Po Edi Rama, që sinqerisht më vjen keq që s’mund ta njohin të gjithë, është babai krejt i veçantë, asnjëherë i pabarabartë me fëmijën. Gregun dhe Rean i sheh dhe trajton si njerëz të lirë, duke i sfiduar në biseda, ku kurrë nuk imponohet me forcën e më të madhit, po krijon hapësira dhe hap dritare komunikimi nganjëherë të çuditshme për mënyrën sesi zgjidh me ta dilemat apo problemet e tyre, pa i rënë asnjëherë bisedës në rrugën e zakonshme të autoritetit prindëror.

Vendimi për martesë ishte një përfundim logjik i lidhjes së dy të rriturve apo një dëshirë e beftë e ndonjërit prej jush?

Tashmë, ngjarja e martesës sonë është e shkuar dhe vendimmarrja për të është jeta jonë e përditshme së bashku, të cilën e kemi dëshiruar që të dy dhe të dy jemi të lumtur për vendimin që kemi marrë.

Si është një ditë në krah të Edi Ramës? Si janë fundjavat tua, kur nuk janë të mbushura me aktivitete politike?

Çdo moment në krah të Edit është, pa asnjë ekzagjerim, një arsye për të thënë diçka të bukur, por do të më lejoni t’i mbaj për vete ato që mund të them, si pjesë të një jetese që kemi zgjedhur ta mbajmë jashtë dhe sa më larg vëmendjes së të tjerëve.

Tregohet e kursyer në të tilla detaje Linda Rama. Si me një kufi të padukshëm, i ndan mirë ato gjëra që mund t’i ndajë me të gjithë, nga ato që ka vendosur t’irruajë rigorozisht brenda mureve të shtëpisë, të asaj

shtëpie e cila u komentua gjatë në media për faktin se është banesa me qira e njeriut më të përfolur nga shumica qeverisësiabuzuesmelejetendërtimit... Për Linda Ramën, këto janë përbaltjet që ajo nuk i komenton fare, kurse shtëpia prej 90 metrash katrorë është shtëpia brenda së cilës ajo ndjehet më mirë se kudo. Në fund të fundit, është një e sapomartuar, si gjithë të sapomartuarit në gjithë botën, që, me siguri, kërkon sa më shumë momente vetëm.

A ndiheni e bezdisur nga prania e përhershme e bashkëpunëtorëve të tij, truprojave, shoferit... ? Sa kohë kaloni vetëm ju të dy?

Nuk ndihem e bezdisur, sepse e kam pranuar specifikën e punës së tij me të gjitha andrallat e panumërta. Po, ndërkohë, nuk jam as e detyruar të provoj durimin tim lidhur me praninë e atyre që përmendet, pasi, kur Edi është me mua, është përgjithësisht vetëm me mua, sepse kohën që mbetet vetëm për njëri-tjetrin e kalojmë më së shumti në shtëpi.

A i shmangni bisedat politike brenda mureve të shtëpisë?

Na pëlqen ta kalojmë mbrëmjen në shtëpi me bisedash, filmash, leximesh apo edhe ndonjë ndeshjeje të veçantë sporti, që Edi më detyron ta shoh.

Tani që folët për sportin, më kujtohet që në revistën “One”, Edi ka folur për vrapimin, sportin që ai nuk e ka braktisur dhe që e ushtron bashkë me Gregun. A i jeni bashkangjitur dhe ju këtij ekipi?

Kam patur gjithnjë një respekt të veçantë për sportistët e talentuar, por nuk jam dalluar ndonjëherë as për talent e as për vullnet të veçantë për t’u marrë me sport. Ndërkohë që, me hope, bëj edhe unë përpjekjet e mia, për të mos e lënë organizmin në gjumin e viteve që ikin.

Por ama ka një tjetër “sport” që ju e bëni në çift, “shopping”- u, domethënë pazari ushqimor. Na thanë se jeni blerës të rregullt të supermarketit ku dhe ju kanë fotografuar. Kjo do të thotë që te ju nuk mungojnë vaktet e gatuar rregullisht në shtëpi? Cilat janë ushqimet e parapëlqyera?

Hamë thjesht, ushqime jo të rënda e kam fjalën. Pjata e preferuar janë angjinaret, të cilat janë gatuar tradicionalisht në familjen e Edit dhe në mënyrat e ndryshme të gatimit ato shijojnë vërtet shumë.

Edi gatuan?!

Sigurisht, kur ia lejon koha dhe ia ka vërtet qejfi ta bëjë këtë, duke sajuar pjata të pakonkurrueshme, por, fatkeqësisht, nuk ndodh aq shpesh sa do të doja.



**Folët për gatime tradicionale të familjes së Edit.
A keni marrë ndërkaq “mësime” gatimi nga
mamaja e Edit?**

Konsultohem vazhdimisht për gatimin, si me
mamanë e Edit, ashtu edhe me mamanë time. Kur
ato gatuajnë diçka të veçantë, shijojmë gatimin e
tyre, i cili na kujton fëmijërinë.

Cilat janë ato punë të shtëpisë që urreni t’i bëni?

Unë i kam bërë gjithnjë vetë punët e shtëpisë. Nuk
kam marrë asnjëherë njeri për të më ndihmuar.
Në qoftë se e do shtëpinë ku jeton, nuk mund të
urresh asnjë prej punëve që bën në të. Përkundrazi.

**Si është arredimi i shtëpisë suaj? Me ç’ngjyra?
Piktori i shtëpisë është Edi apo ti?**

Është një shtëpi e vogël, që, sigurisht, syri dhe dora
e Edit e kanë bërë një shtëpi të veçantë, pa asnjë
mur ndarës, për shembull dhe me një organizim të
përshtatur për të ndarë orë mikpritjeje me njerëz
të dashur tanët, pavarësisht hapësirës modeste.
Ngjyrat? E kuqja, grija dhe e bardha janë ato që
dominojnë, por ka tek tuk ndonjë “njollë” të gjelbër
apo blu.

**U fol gjatë në media për zgjedhjen për të jetuar
në këtë shtëpi me qira... Do jetoni përgjithmonë
në një shtëpi të tillë apo planifikoni ta blini një?**

Si të gjithë, edhe ne e kemi ëndërr të kemi shtëpinë
tonë, që duam ta ndërtojmë vetë dalëngadalë.
Madje, unë e kam filluar ndërtimin e kësaj shtëpie
në ëndrrën time. I di përmendësh muret, mjediset,
mobilimin, gjithçka. Jam e lumtur që Edi iu bashkua
kësaj ëndrre.

Duket si një nga ato përrallat me fund të lumtur, ku
dynjerëztërriturvendosintëngrenështëpinëetyre,
familjenetyre,dukepasurfëmijëtetyre.Gregu,djali
i Edit dhe Rea,vajza e Lindës,janë shfaqur të lumtur
në krah të prindërve ditën e dasmës.

Si ka ndikuar vendimi për martesën në jetën e vajzës suaj?

Rea është një fëmijë i rritur mjaft mirë, me dashuri shumë të veçantë, në një mjedis ku kujdesi dhe respekti i ndërsjellë ishte pjesë e pacenuar kurrë e kodit të çmuar familjar. Falë dashurisë e përkushtimit të jashtëzakonshëm të babait të saj dhe timit në çdo çast për vite me radhë, Rea është sot një vajzë me botë të madhe shpirtërore, mendjehapur, kurajoze. E pakursyer në dashurinë për gjyshen, të atin e saj e për mua, ajo mban në një ekuilibër të përsosur marrëdhëniet e veta me të dyja shtëpitë.

Si ka reaguar ajo kur mësoi lidhjen tuaj me Edin dhe, më vonë, vendimin për martesën.

Marrëdhënia e Reas me Edin është një kapitull i bukur më vete. Që pas futjes së vajzës në rrugën e studimit të arkitekturës e të artit, ka një hapësirë diskutimi të vazhdueshëm mes tyre. Nëna ime, me të drejtë, është shumë kritike ndaj prindërve që kalojnë masën në lëvdatat për fëmijët e tyre, ndaj shpresoj që, kur ta lexojë këtë bisedë tonën, të mos më marrë në telefon për të më thënë se e kalova masën duke folur për time bijë.

Disa herë gjatë bisedës sonë dëgjova të përmendnit “fëmijët”, në shumës. Kjo do të thotë që Gregun e shihni si djalin tuaj? Si është marrëdhënia me të?

Sigurisht që fëmijët tanë janë njëloj pjesë e jona dhe jemi të bekuar që i kemi. Gregu është bashkëmoshatar me Rean, madje, kanë qenë në vitin e parë të shkollës së mesme në të njëjtën klasë. Binte në sy qysh atëherë si krejt i ndryshëm nga shokët e shoqet e klasës së sime bije, jo vetëm pse shumë i gjatë, po njëkohësisht shumë i mirësjellë. Djali ka kaluar një vështirësi të madhe shëndetësore pesë vjet më parë, që e ka ndikuar dhe ndihmuar shumë në pasjen e një thellësie, po edhe humori të veçantë. Me mua ka një komunikim “të fshehtë”, e them duke buzëqeshur, sepse dëshiron të ndajë çdo pikëpyetje nga shumë pikëpyetjet e natyrshme të moshës. Edhe ai merret me art, pikturon e fotografon bukur, po unë mezi i pres copëzat e shkrimeve të tij, që m’i dërgon rregullisht.

Keni thënë në të parën dhe të vetmen intervistë se me Anetën, nënën e Edit, keni një marrëdhënie miqësore. Sa kohë ka që zgjat kjo miqësi? I ndani bashkë shqetësimet, kur jeta private e Edit përdoret për sulme politike? Si reagon ajo në raste të tilla? Po ti?

Aneta Rama është, përtej marrëdhënies sime shumë të afërt me të, një grua shumë e rrallë. Këto ditë më rastisi të shoh një dosje me vizatime të

fëmijërisë së hershme të Edit e të Olsit, të ruajtura me shumë kujdes nga babai i Edit, Kristaqi, në një koleksion ku mbishkruhej prej dorës së tij “kujtimet e fëmijve”. Veçanërisht, njëra prej tyre më preku shumë. E nxora mënjane, për ta vënë në murin e shtëpisë. Është një vizatim i Edit. Me shkrimin e një fëmije 6 vjeçar shkruhet mbi një det ku kalon një vapor shumëngjyrësh: “5-11-70 MAMIT TIME-NGA EDI”. Kjo, më duket mua, se do të ishte pamja më e përshtatshme për të përshkruar atmosferën në familjen Rama sot e gjithë kohën. Aneta është një grua e kulturuar, e cila karrierën e saj e la mënjane duke mbështetur burrin që adhuronte dhe rritur me përkujdesje të madhe fëmijët e saj. Është një nënë që di të respektojë zgjedhjen politike të të birit, përtej dhimbjes prej goditjeve të paturpshme që i bëhen pa pushim familjes së saj, kujtimit të burrit të saj. Ndërsa Edi është për të djali që kalimi i viteve përmes vështirësisë së mundimshme të krijuar prej sulmeve të baltës e bën edhe më të ndjeshëm ndaj saj. Nën peshën e brengës për lëndimin që shkakton tek nëna fjala e rëndë deri në mëkat e kundërshtarëve politikë të të birit, Aneta merr çdo ditë përkëdheljet e tij telefonike, kur koha nuk lejon më shumë dhe, shpeshherë, një tufë lule dërguar prej Edit në shtëpi. Ndërsa unë jam vazhdimisht me të. Jemi të shqetësuar, kur ajo shqetësohet dhe bëjmë sa mundemi ta qetësojmë e ta gëzojmë.